



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar

Plani Strategjik 2026 - 2028

Prishtinë, mars 2026

Fjala hyrëse e Ushtresit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të AAPSK-së

Në cilësinë e Ushtresit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK), kam nderin të prezantoj Planin Zhvillimor Strategjik të AAPSK-së për periudhën 2026–2028.

Ky institucion ka për mision administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, duke përfshirë magazinimin, ruajtjen e përkohshme, shitjen, dhënien me qira, dhënien në shfrytëzim pa kompensim, si dhe vlerësimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Po ashtu, AAPSK kujdeset për derdhjen e mjeteve financiare të fituara nga shitja e pasurisë së konfiskuar në përputhje me ligjin dhe ndërmerr çdo aktivitet tjetër të nevojshëm për ruajtjen dhe mbajtjen e vlerës së pasurisë.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të saj, AAPSK synon që punën dhe objektivat e përcaktuara në këtë strategji t'i udhëheqë mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë, paanshmërisë, llogaridhënies, transparencës dhe tolerancës, duke mbetur gjithnjë e përkushtuar në përmbushjen e detyrave të saj.

Falë përkrahjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me akterët vendorë dhe ndërkombëtarë, që nga themelimi i saj në vitin 2010 si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e deri më sot, AAPSK ka ndërtuar një përvojë të konsiderueshme në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Në veçanti, është krijuar një infrastrukturë ligjore dhe një praktikë e qëndrueshme sa i përket procedurave të pranimit, vlerësimit, ruajtjes dhe shitjes së pasurisë. Deri më tani, AAPSK ka administruar lloje të ndryshme të pasurive, duke ndërmarrë veprimet e nevojshme për ruajtjen adekuate dhe sigurimin e vlerës së tyre.

Mund të konstatojmë se gjatë një dekadë e gjysmë të funksionimit është realizuar një punë e mirë, e cila synohet të avancohet edhe më tej në vitet në vijim. Pikërisht për këtë qëllim është hartuar Strategjia e Zhvillimit të Agjencisë për periudhën 2026–2028.

Pas një analize të punës së deritanishme, në konsultim të vazhdueshëm me stafin drejtues dhe me ekspertin e angazhuar për hartimin e kësaj strategjie, është përgatitur ky dokument strategjik, i cili synon fuqizimin e Agjencisë në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe arritjen e misionit të saj në mënyrë sa më efektive dhe efektive, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Objektivat e përcaktuara do të arrihen përmes fuqizimit institucional, përmirësimit të infrastrukturës ligjore, avancimit të procesit të digjitalizimit, planifikimit para sekuestrimit, mundësisimit të shitjes në fazën e sekuestrimit, ngritjes së kapaciteteve për administrimin e kripto-aseteve dhe pasurive komplekse, përmirësimit të proceseve të administrimit, si dhe vazhdimin të partneritetit me akterët ndërkombëtarë dhe institucionet e zbatimit të ligjit.

Në këtë strategji është ndjekur një qasje praktike, duke hartuar një plan konkret veprimi me afate të qarta kohore dhe tregues të matshëm për monitorimin e realizimit të objektivave. Vlerësoj se kjo strategji është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe se zbatimi i saj do të kontribuojë në administrimin sa më të mirë të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe në fuqizimin e mëtejshëm të AAPSK-së.

Në fund, shfrytëzoj rastin të falënderoj GIZ-in, ekspertin e angazhuar në kuadër të GIZ-it, si dhe grupin punues për kontributin e tyre në hartimin e kësaj strategjie, duke mirëpritur zbatimin e saj.

Alban Sutaj,
U.D. Drejtor i Përgjithshëm i AAPSK-së

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	5
2. Metodologjia	6
3. Analizimi i situatës	6
4. Vizioni	9
5. Misioni	9
6. Vlerat	9
7. Objektivat Strategjike dhe Specifike	10
7.1. Objektiva Strategjike 1: Forcimi i kapaciteteve të AAPSK-së në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar	10
7.2. Objektiva Strategjike 2: Avancimi i procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar	11
7.3. Objektiva Strategjike 3: Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar	12
8. Rreziqet potenciale dhe masat minimizuese	13
9. Monitorimi dhe raportimi	15
10. Shtojcat	16
10.1. Dokumente të konsultuara	16

Shkurtesat

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
APSK	Administrimi i Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
BE	Bashkimi Evropian
CPI	Corruption Perception Index
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
KiE	Këshilli i Evropës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
PECK	Project against Economic Crime in Kosovo
PSK	Pasuria e Sekuestruar dhe Konfiskuar
SMIL	Sistemi për Menaxhimin e Informatave dhe Lëndëve
ZAP	Zyrat e Administrimit të Pasurisë

1. Hyrje

Në kuadër të ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme institucionale që pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Ministria e Drejtësisë (MD) në vitin 2010 ka themeluar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK). AAPSK është themeluar në vitin 2010 sipas Ligjit Nr. 03/L-141 të 10 korrikut 2009 mbi Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, më pas i zëvendësuar me Ligjin Nr. 05/L-049 i datës 24 mars 2016. AAPSK është themeluar sipas standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Zyrat e Administrimit të Pasurisë (ZAP)” (Projekti PECK III)¹.

AAPSK vepron si mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i administrimit profesional të Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (PSK). AAPSK ka vazhduar ta zbatojë me sukses mandatin e saj, ta përmirësojë gradualisht performancën e saj dhe ta rrisë ndikimin e saj tek agjencitë e zbatimit të ligjit sa i përket një administrimi sa më efektiv dhe sa më efikas të PSK-së.

Gjithsesi, duke e marrë parasysh ngathtësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe zhvillimeve më të reja sa u përket përpjekjeve institucionale në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar ka hapësirë për avancimin e performancës së përgjithshme të AAPSK-së, përfshirë shtrirjen e ndikimit të saj te agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit në lidhje me administrimin e PSK-së. Zhvillimi dhe avancimi i mëtejshëm i AAPSK-së është i nevojshëm tanimë kur Kosova edhe zyrtarisht ka aplikuar për anëtarësim në BE dhe ku performanca e përgjithshme e administratës publike duhet të lëvizë në nivele më të larta drejt përafrimit me praktikat më të mira dhe standardet e BE-së.

Prandaj, për t’iu përgjigjur zhvillimeve më të reja AAPSK ka dizajnuar këtë Plan Strategjik 2026-2028, i cili përmes vizionit, misionit, objektivave strategjike e specifike synon të përmirësojë punën e saj në plan afatmesëm gjithnjë në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi, praktikat më të mira dhe standardet e BE-së. Ky plan shërben edhe për të prioritetuar përpjekjet e AAPSK-së në ato fusha që konsiderohen të nevojshme, gjithnjë brenda mandatit dhe legjislacionit në fuqi.

Plani Strategjik Zhvillimor 2026–2028 pritet të forcojë rolin e AAPSK-së dhe të mbështesë tranzicionin e saj drejt një autoriteti më pro aktiv dhe të orientuar drejt performancës në menaxhimin e pasurive, që ruan vlerën dhe forcon besimin publik. Ai synon të rrisë shndërrimin e sekuestrimeve në konfiskime përfundimtare dhe të përmirësojë vlerën e përgjithshme të rikthyer përmes vendimeve më të hershme dhe më të informuara përgjatë ciklit jetësor të pasurisë, nga planifikimi dhe vlerësimi para sekuestrimit, përmes mirëmbajtjes dhe kontrollit të amortizimit, deri te tjetërsimi në kohë dhe raportimi transparent. Plani do të promovojë një kulturë më të qëndrueshme bashkëpunimi dhe shkëmbimi në kohë të informacionit ndërmjet AAPSK-së, organeve të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe gjykatave, duke siguruar që Agjencia të merret në konsideratë në mënyrë të rregullt gjatë gjithë ciklit

¹ PECK III përbën shkurtësën e Projektit kundër Krimit Ekonomik (originali në anglisht “Project against Economic Crime in Kosovo”). Ky projekt tanimë është fazën e tretë e tij të filluar më 1 korrik 2020 dhe do të përfundojë në 30 qershor 2023. Projekti është një bashkëfinancim nga Komisioni Evropian (89.9%) dhe Këshilli i Evropës (10.1%), ndërkohë që është duke u zbatuar nga Këshilli i Evropës, gjegjësisht nga Divizioni për Bashkëpunim dhe Krime Ekonomik, Institucionet kryesore përfutuese në Kosovë nga ky projekt janë: Njësia e Inteligjencës Financiare, Agjencia për Kundër Korrupsionit, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar dhe Policia e Kosovës – Departamenti Ekonomik, Krime Financiare dhe Korrupsioni. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur një dokument teknik mbi “Rishikimi i Kornizës Ligjore dhe Operacionale të Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara: Vlerësim i nevojave për rritje të efikasitetit”.

jetësor të pasurisë. Përveç kësaj, AAPSK do të avokojë për baza më të forta të të dhënave dhe digjitalizimit për të mbështetur llogaridhënien dhe raportimin në përputhje me Bashkimi Evropian, kapacitete të synuara të stafit për të menaxhuar pasuri komplekse dhe digjitale, si dhe reforma të realizueshme që forcojnë stimujt dhe përfitimin publik, përfshirë një fond konfiskimi dhe rrugë më të qarta për ripërdorim shtetëror dhe social.

2. Metodologjia

Metodologjia e dizajnit të Planit Strategjik ka kaluar nëpër disa faza:

- **Procesi i konsultimit** - Si pjesë e metodologjisë, AAPSK krijoi një grup punues dhe mbajti një seri takimesh për të shqyrtuar gjendjen aktuale të strategjisë dhe për të rënë dakord për një qasje vlerësimi të përafuar me kapacitetet e Agjencisë. Procesi përfshiu mbledhjen dhe analizën e dokumenteve të brendshme, përfshirë ligjet përkatëse, aktet nënligjore, rregulloret dhe procedurat, për të siguruar një bazë fillestare të saktë. Konsultimet me ekspertin ndërkombëtar dhe GIZ ndihmuan në përcaktimin e hapave të mëtejshme dhe në formësimin e kornizës analitike. Paralelisht, eksperti ndërkombëtar zhvilloi intervista me profesionistë relevantë, dhe gjetjet u konsoliduan në Koncept Dokumentin për Hartimin e Planit Strategjik Zhvillimor 2026–2028 për AAPSK-në, i cili përfshiu mangësitë kryesore dhe rekomandimet nga plani i mëparshëm dhe u konfirmua përmes diskutimeve të mëtejshme të grupit punues.
- **Faza e identifikimit të rreziqeve potenciale, treguesve, monitorimit dhe raportimit** Në një punëtori tjetër janë identifikuar rreziqet potenciale që do të mund ta prekin zbatimin e Planit Strategjik si dhe masat për minimizimin e tyre. Po ashtu janë definuar edhe treguesit që do të konfirmojnë përmbushjen e objektivave strategjike dhe specifike. AAPSK do të sigurohet që për secilën objektivë strategjike do të emërojë nga një përgjegjës, i cili/ e cila do të monitorojë zbatimin e aktiviteteteve brenda fushë veprimtarisë që mbulon ajo objektivë strategjike.
- **Faza e përfundimit dhe miratimit të planit strategjik** – Pas procesit të hartimit, në Plan Strategjik janë përfshirë të gjitha komentet dhe sugjerimet dhe krejt në fund Plani është miratuar nga AAPSK dhe MD.

3. Analizimi i situatës

Kosova që nga viti 2009 ka nxjerrë legjislacionin si dhe ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për të parandaluar dhe luftuar veprimet korruptive, përfshirë përfitimet pasurisë së kundërligjshme si dhe për t'i administruar këto pasuri pas sekuestrimit dhe konfiskimit të tyre. Baza ligjore e Kosovës për sekuestrim dhe konfiskim është ndryshuar ndjeshëm duke filluar nga Ligji Nr. 03/L-141 të 10 korrikut 2009, i cili parashihte një Zyrë për Administrim të Pasurisë, pra AAPSK, më pas i zëvendësuar me Ligjin Nr. 05/L-049 i datës 24 mars 2016 (Ligji AAPSK). Për më tepër, me kompetencat e zgjeruara të konfiskimit (prezantuar për herë të parë në vitin 2013 me Ligjin Nr. 04/L-140, më pas i zëvendësuar me Ligjin Nr. 06/ L-087 të 23 nëntorit 2018) janë

në dispozicion, duke bërë të mundur verifikimin e pasurisë së personave të shpallur fajtorë për një listë të gjatë të krimeve që gjenerojnë fitime dhe konfiskimin e asaj pasurie.

Ndërkohë që Kosova nga 2009 ka vazhduar të sekuestrojë dhe konfiskojë pasuri të fituar në mënyrë të kundërligjshme. Sipas *Transparency International* "Kosova që nga viti 2012 e tutje vazhdimisht ka shënuar progres në Indeksin e Përceptimit të Korrupsionit (CPI2022)" edhe pse korrupsioni vazhdon të ngelet sfidë për sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Dhe si rezultat i ngathtësisë së gjyqësorit që lidhet dhe me korrupsionin niveli i konfiskimeve vazhdon të ngelet i ulët. Kjo ka bërë që besimi në gjyqësor të jetë i ulët.

Sipas Raportit Vjetor të AAPSK-së gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar 203 vendime të gjykatave, prej të cilave vlera e pasurisë së sekuestruar ishte 4,612,034.41 EUR, kurse 1,256,631.34 EUR pasuri e konfiskuar. Ndërkohë që në Raportin e vitit 2025 janë ekzekutuar 187 vendime të gjykatave, prej të cilave 3,480,337.65 EUR pasuri e sekuestruar, kurse 120,326.49 pasuri e konfiskuar.

Raporti për Kosovën 2025 i Bashkimit Evropian thekson se shumica e pasurive ende mbeten nën sekuestrim të përkohshëm, ndërsa konfiskimet përfundimtare përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të numrit dhe vlerës totale të pasurive. Kjo tregon nevojën për të forcuar hetimet financiare, për të përmirësuar efikasitetin gjyqësor dhe për të rritur kapacitetet e menaxhimit të pasurive. Hendeku i vazhdueshëm ndërmjet pasurive të sekuestruara dhe atyre të konfiskuara përfundimisht tregon se ka sfida përgjatë gjithë procesit të rikuperimit të pasurive dhe konfirmon se rritja e konfiskimeve përfundimtare duhet të mbetet një prioritet strategjik në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në përgjithësi vlera e pasurisë së konfiskuar vazhdon të ngelet tejte e ulët krahasuar vlerat e pasurisë së sekuestruar. Njëra ndër vështirësitë kryesore që ka penguar këtë proces në tërësinë e tij është bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional i ngritur si shqetësim në pothuaj të gjitha Raportet e BE-së për Kosovën dhe jo vetëm. Edhe sipas Strategjisë së Sundimit të Ligjit 2021-2026 "konfiskimi i pasurisë që derivon nga veprat penale mbetet gjithashtu sfidë kyçe. Pavarësisht, që një pjesë e caktuar e pasurisë së tillë sekuestrohet në mënyrë të suksesshme, ajo kryesisht nuk konfiskohet me vendim përfundimtar të gjykatave. Për ilustrim, në vitin 2025, janë konfiskuar pasuri në vlerë prej 120,326.49 EUR kurse janë kthyer tek pronarët pasuri në vlerë prej 424,326.29 EUR.

Ndërkohë që, AAPSK - duke qenë institucioni përgjegjës për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (APSK) - vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme për të kryer plotësisht funksionin e saj si agjenci e zbatimit të ligjit, veçanërisht në ruajtjen e vlerës së pasurisë së sekuestruar gjatë procedurave të gjata gjyqësore. Për më tepër Kosova ende nuk ka një fond të konfiskimit, i cili do të mund t'i ndante fondet e konfiskuara pjesërisht për zbatimin e ligjit, prokurorinë, gjykatat dhe pjesërisht për projektet sociale.

AAPSK vazhdon të përballet me vështirësi në administrimin pasurisë nën kompetencën e saj, pjesërisht për shkak të moslejimit nga gjykatat për shitjen e pasurisë së sekuestruar, e cila duke pritur procedurat e gjata gjyqësore amortizohet dhe zhvlerësohet. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore vazhdon të ngelet ndër çështjet më kritike dhe komplekse të gjyqësorit duke ndikuar drejtë për drejtë në të drejtën për gjykim brenda afateve të arsyeshme të parapara me ligje dhe kushtetutë.

Sipas Raporti të Projektit PECK III procesi i administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar është duke u përballur me disa vështirësi siç janë: vështirësitë financiare të funksionimit të AAPSK-së, përshkrimet 'gjenerike' të vendeve të punës së stafit të AAPSK-së, kapacitetet e kufizuara të burimeve njerëzore, mungesa e trajnimeve të përbashkëta mes AAPSK-së, gjykatave, prokurorive dhe agjencive të zbatimit të ligjit mbi përgjegjësitë institucionale sa i përket procesit të sekuestrimit dhe konfiskimit, humbja e vlerës së pasurive të sekuestruara dhe pamundësia për t'i shitur, mungesa e një baze adekuate të dhënash përmes së cilës do të nxirreshin statistika të besueshme, mos ndërlidhja e AAPSK-së me SMIL e vështirëson bashkëpunimin ndërinstitucional me gjykata dhe prokurori, hapësirat e fizike të pamjaftueshme dhe jo adekuate për të siguruar ruajtjen e pasurive të sekuestruara, etj.

Për ta pasur një pasqyrë sa më të qartë dhe sa më gjithëpërfshirëse mbi nevojat e AAPSK-së në përmbushjen e mandatit të saj, janë identifikuar disa faktorë që sfidojnë punën e AAPSK-së siç janë:

- Planifikim i pamjaftueshëm para sekuestrimit dhe konsultim i kufizuar me Agjencinë
- Zhvlerësim i vlerës së pasurive të sekuestruara
- Mirëmbajtje e pamjaftueshme e vlerës së pasurive dhe ndjekje statistikore e kufizuar
- Bashkëpunim i pamjaftueshëm ndërinstitucional dhe ndërkombëtar
- Kapacitet dhe infrastrukturë e kufizuar për menaxhimin e pasurive digjitale dhe krypto
- Mungesë e një fondi konfiskimi dhe ripërdorim i kufizuar shtetëror dhe social i të ardhurave nga pasuritë e konfiskuara përfundimisht
- Kufizime legjislative që ndikojnë në menaxhimin e pasurive
- Mungesë e ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimeve të specializuara në menaxhimin e pasurive
- Mungesë e një regjistri qendror kombëtar për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara
- Pasuri të dorëzuara në AAPSK për administrim para se të merret një urdhër gjykate

Për t'i adresuar vështirësitë e mësipërme ky Plan Strategjik i AAPSK-së është në përputhje të plotë me një sërë dokumentesh qeveritare duke filluar nga Plani Institucional i Ministrisë së Drejtësisë. Më tej ky plan strategjik është në përputhje me Strategjinë për Sundim të Ligjit 2021-2026 që parasheh reformë të gjithmbarshme të sistemit të drejtësisë duke u përqendruar në 4 objektiva strategjike si: 1) Fuqizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial, 2) Fuqizimi i drejtësisë penale, 3) Fuqizimi i qasjes në drejtësi, dhe 4) Fuqizimi i luftës anti-korrupsion.

Po ashtu, plani strategjik është në përputhje me Planin Kombëtar për Zhvillim 2030, i cili ka këto prioritete strategjike: 1) Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, 2) Zhvillim i barabartë njerëzor, 3) Siguri dhe sundim të ligjit, dhe 4) Qeverisje të mirë. Përmes analizimit të gjendjes së përgjithshme të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar si dhe ndërlidhjes së tyre me dokumentet e lartpërmendura kanë derivuar dhe vizioni, misioni, vlerat dhe objektivat e këtij Plani Strategjik të AAPSK-së 2026-2028.

4. Vizioni

Agjenci qendrore moderne sa më profesionale në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar.

5. Misioni

Agjencia administron pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar në mënyrë sa më efektive dhe sa më efektive sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare

6. Vlerat

Integriteti – Agjencia kryen punën e saj në mënyrë profesionale sipas mandatit ligjor që ka;

Transparenca dhe llogaridhënia – Lidhur me punën e saj dhe mandatin e saj ligjor dhe për atë sa lejon ligji agjencia do të jetë transparente;

Pa-anshmëria – Agjencia siguron që procesi i administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar të jetë paanshëm dhe i pandikueshëm gjithnjë duke synuar rritjen e besueshmërisë së qytetarëve kundrejt punës së agjencisë;

Toleranca (Diversiteti) – Gjatë procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, agjencia vepron ndaj palëve pa dallim etnie, gjinie, religjioni, etj.;

Inovacioni – Agjencia synon të hulumtojë dhe përdorë metoda, procese dhe mjete të reja për ta rritur efikasitetin e saj;

Konfidencialiteti – Agjencia ruan konfidencialitetin e të dhënave gjatë tërë punës së saj;

Bashkëpunimi – Agjencia është e hapur për bashkëpunim me të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë që kontribuojnë në procesin e sekuestrimit, konfiskimit dhe administrimit të pasurisë;

Pajtueshmëria - Agjencia vepron në përputhje të plotë me ligjet dhe procedurat në fuqi;

Cilësia dhe profesionalizmi - Agjencia promovon punë ekipore respektuese dhe konstruktive si dhe përgjegjësi të përbashkët, duke ruajtur standarde të larta të punës, dokumentimit dhe ofrimit të shërbimeve në përputhje me mandatin e saj.

7. Objektivat Strategjike dhe Specifike

7.1. Objektiva Strategjike 1: Forcimi i kapaciteteve të AAPSK-së në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar

Në kuadër të Objektives së parë strategjike janë identifikuar tri objektiva specifike siç janë: 1.1) Avancimi i kornizës ligjore; 1.2) Fuqizimi i kapaciteteve të specializuara dhe ekspertizës teknike; dhe 1.3) Digjitalizimi i AAPSK-së.

Në mënyrë që të arrihet ky objektivi specifik, do të hartohet legjislacioni i ri dhe AAPSK do të propozojë ndryshime dhe përmirësime të reja në ligjet ekzistuese dhe legjislacionin plotësues për të krijuar një kornizë efektive për rikuperimin dhe menaxhimin e pasurive.

Ngrija e kapaciteteve do të arrihet përmes trajnimeve të synuara dhe të specializuara për stafin.

Digjitalizimi i AAPSK-së duhet të forcohet përmes përfundimit të Platformës së Ankandit Online dhe lidhjes së bazës së të dhënave të AAPSK-së, pasi të krijohet, me SMIL të gjykatave dhe prokurorive. Nëse kjo nuk është e realizueshme, rekomandohet të krijohet një regjistër kombëtar që regjistron të gjitha pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (fizike dhe digjitale), i ndarë nga SMIL.

Objektiva Strategjike	Objektivat Specifike	Treguesit
1. Forcimi i kapaciteteve të AAPSK-së në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara	1.1. Avancimi i kornizës ligjore	1.1.1. Përpjekja për bashkëpunimin me institucionet ligj zbatuese për të qartësuar konsultimin me AAPSK-në dhe kërkesat për informacion
		1.1.2. Propozimi për ndryshim të legjislacionit për të autorizuar AAPSK-në që të kërkojë drejtpërdrejt miratimin për shitje para vendimit gjyqësor përfundimtar, në fazën e sekuestrimit, me qëllim ruajtjen e vlerës së aseteve
		1.1.3. Hartimi i dokumentit dhe modelit të qeverisjes për fondin e konfiskimit, dhe dorëzimi në institucionin kompetent
	1.2. Fuqizimi i kapaciteteve të specializuara dhe ekspertizës teknike	1.2.1. Numri i trajnimeve të specializuara, për menaxhimin e aseteve, të realizuara për stafin e AAPSK-së
1.2.2. zyrtarë të AAPSK-së, të trajnuar, për të siguruar që Agjencia të jetë operacionalisht e gatshme për menaxhimin e aseteve digjitale sapo të paraqiten raste relevante të sekuestrimit dhe konfiskimit të këtyre aseteve, si dhe pasi të jetë krijuar një kuletë digjitale		
1.2.3. Numri i pjesëmarrësve të stafit në ngjarje dhe iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare		

		1.2.4. Numri i mjeteve dhe procedurave kryesore të brendshme të zhvilluara/përditësuara për menaxhimin e asetëve (përfshirë asetet komplekse ose digjitale).
	1.3. Digjitalizimi i AAPSK-së	1.3.1. Funkcionalizimi i plotë Platformës së Ankandit Online dhe lidhja e saj me bazën e të dhënave të AAPSK-së

7.2. Objektiva Strategjike 2: Avancimi i procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar

Në kuadër të Objektives së dytë Strategjike janë identifikuar tri objektiva specifike: 2.1) Modernizimi dhe standardizimi i vazhdueshëm i punës së AAPSK-së; 2.2) Mundësimi i shitjes më të hershme të pasurive të sekuestruara dhe forcimi i rolit të Agjencisë; dhe 2.3) Përmirësimi i infrastrukturës fizike.

Përbushja e Objektivit të parë Strategjik do të kontribuojë drejtpërdrejt në përbushjen e Objektivit të dytë Strategjik dhe mundësimin e shitjes më të hershme të pasurive të sekuestruara, pasi ndryshimet në ligj duhet të përfshijnë shitjet e hershme, konsultimin e detyrueshëm dhe vlerësimin paraprak të pasurive. Modernizimi do të arrihet përmes ankandëve të zhvilluara, ku për këtë qëllim, do të finalizohet edhe Platforma e Ankandëve Online. Përmirësimi i infrastrukturës fizike duhet të synohet përmes një kërkesë për një hapësirë të përhershme depoje, preferohet një pasuri e konfiskuar që përdoret për këtë qëllim, si dhe për hapësira të punës për stafin e agjencisë.

Arritja e kësaj objektive strategjike dhe atyre specifike do konfirmohet përmes treguesve të identifikuar si më poshtë.

Objektiva Strategjike	Objektivat Specifike	Treguesit
2. Avancimi i procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar	2.1. Modernizimi dhe standardizimi i vazhdueshëm i punës së AAPSK-së	2.1.1. Numri i ankandëve të zhvilluara
		2.1.2. Numri i vendimeve të zbatuara nga AAPSK që pranohen nga institucionet përkatëse
	2.2. Mundësimi i shitjes më të hershme të pasurive të sekuestruara dhe forcimi i rolit të Agjencisë	2.2.1. Numri i kërkesave drejtuar prokurorëve për shitjen e pasurive në fazën para gjykimit dhe numri i miratimeve nga gjykata
		2.3. Përmirësimi i infrastrukturës fizike
	2.3.2. Kërkesë për hapësira të punës për stafin e agjencisë	

7.3.Objektiva Strategjike 3: Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar

Në kuadër të Objektivës së tretë Strategjike janë identifikuar tri objektiva specifike: 3.1) Sensibilizimi mbi rolin dhe mandatin e AAPSK-së ndër institucionet vendore; 3.2) Rritja e ndërgjegjësimit për menaxhimin e pasurive dhe promovimi i AAPSK-së për të forcuar transparencën institucionale dhe besimin publik; 3.3) Vazhdimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe përshtatja e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rajonale; 3.4) Përmirësimi dhe promovimi i ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.

Koordinimi i kufizuar ndër-institucional dhe shkëmbimi i informacionit mbetet një sfidë kyçe për arritjen e objektivave të Agjencisë. Pavarësisht rolit qendror të AAPSK-së në menaxhimin e pasurive, ajo ende shpesh perceptohet si një institucion mbështetës, dhe prokurorët nuk e konsultojnë ose njoftojnë në mënyrë të qëndrueshme Agjencinë në rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit, në kundërshtim me kërkesat ekzistuese ligjore dhe administrative.

Përveç kësaj, bashkëpunimi ndërkombëtar në rastet e rikthimit ndërkufitar të pasurive mbetet i nënshfrytëzuar, duke kufizuar përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Përmbushja e kësaj objektive strategjike do të varet nga përmbushja e Objektivës së parë strategjike ku parashihet të nxirret legjislacioni i nevojshëm për themelimin e fondit të konfiskimit, përmes të cilit pastaj pasuria e konfiskuar do të mund të përdoret për ripërdorim social ashtu sikundër që do të mund të përdoret dhe nga institucionet e zbatimit të ligjit. Arritja e kësaj objektive strategjike dhe atyre specifike do të konfirmohet përmes treguesve të identifikuar si më poshtë.

Fokusi kryesor i këtij objektivi do të jetë rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndër-institucional, veçanërisht bashkëpunimi i AAPSK-së me gjykatat, prokurorinë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Ky bashkëpunim është i pamjaftueshëm për shkak të përlshirjes së kufizuar të Agjencisë në konsultime dhe në planifikimin para sekuestrimit, si dhe për shkak të nivelit të ulët të ndërgjegjësimit për rolin dhe rëndësinë e saj.

Rekomandohet që ky bashkëpunim të forcohet përmes sensibilizimit mbi rolin dhe mandatin e AAPSK-së ndër institucionet vendore; rritjes së ndërgjegjësimit për menaxhimin e pasurive dhe promovimit të agjencisë për të forcuar transparencën institucionale dhe besimin publik; si dhe vazhdimit të koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe përshtatjes së praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rajonale, (p.sh. pjesëmarrje në rrjete rajonale, shkëmbime bilaterale ose vizita studimore). Arritja e këtij objektivi strategjik dhe specifik do të konfirmohet përmes treguesve të identifikuar më poshtë.

Objektiva Strategjike	Objektivat Specifike	Treguesit
3. Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar	3.1 Sensibilizimi mbi rolin dhe mandatin e AAPSK-së ndër institucionet vendore	3.1.1. Numri i takimeve me institucione të zbatimit të ligjit
		3.1.2. Nr. i MoU-ve të nënshkruara
	3.2 Rritja e ndërgjegjësimit për menaxhimin e pasurive dhe promovimi i AAPSK-së për të forcuar transparencën institucionale dhe besimin publik	3.2.1. Krijimi i një videoje promovuese për punën e AAPSK-së
	3.3 Vazhdimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe përshtatja e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rajonale	3.3.1. Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare;
	3.4 Përmirësimi dhe promovimi i ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.	3.4.1. Numri dhe vlera e pasurisë së dhënë për ripërdorim social;
3.4.2. Numri i nismave të mbështetura për ripërdorim shtetëror ose social të pasurive të konfiskuara ose të ardhurave prej tyre (të iniciuara, ose të zbatuara)		

8. Rreziqet potenciale dhe masat minimizuese

AAPSK ka paraparë rreziqet potenciale që do të mund të ndodhnin gjatë fazës së zbatimit të planit strategjik 2026-2028. Në mënyrë që rreziqet mos të prekin zbatimin e planit strategjik, AAPSK ka identifikuar edhe masat për minimizimin e atyre rreziqeve.

Në kuadër të Objektivës së parë Strategjike ("Fuqizimi i AAPSK-së në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar") janë identifikuar rreziqet potenciale dhe masat për minimizimin e tyre gjatë fazës së zbatimit të planit strategjik.

Vonesat në hartimin e legjislacionit – Si masë minimizuese AAPSK do të përpiqet që mos të vonohet hartimi i legjislacionit duke rritur bashkëpunimin me të gjitha institucionet relevante.

Data baza dhe mosndërlidhja e AAPSK-së me SMIL – Si masë minimizuese AAPSK do të kujdeset që së bashku me të gjithë akterët relevantë ta ndërtoj data bazën e të dhënave dhe ta lidhë atë me SMIL, kjo për arsye se një ndërlidhje e tillë do ta rriste efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, do ta rriste bashkëpunimin me polici, gjykata dhe prokurori si dhe do të mundësonte nxjerrjen e statistikave të besueshme dhe të harmonizuara me sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të Objektivës së dytë (“Avancimi i procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar”) **dhe Objektivës së tretë Strategjike** (“Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional”) të këtij plani strategjik janë identifikuar këto rreziqe potenciale dhe masat përkatëse për minimizimin e tyre.

Neglizhimi i rolit të AAPSK-së nga institucionet relevante – Si masë minimizuese AAPSK do të rrisë përpjekjet në sensibilizimin mbi rolin dhe mandatin e saj karshi institucioneve relevante.

Interesimi u ulët i institucioneve në shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme që është e konfiskuar – Si masë minimizuese AAPSK do të kujdeset që të sensibilizojë institucionet në shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme që është konfiskuar.

Në qoftë se rreziqet e lartë përmendura ndodhin gjatë fazës së zbatimit të planit strategjik, atëherë ndërmarrja nga AAPSK e masave përkatëse për minimizimin e tyre do të kontribuojë në përmbushjen e të gjitha objektivave strategjike dhe specifike të këtij plani strategjik. Prandaj, AAPSK ngelet e përkushtuar në monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të planit strategjik në mënyrë që procesi i administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar të bëhet konform legjislacionit në fuqi si dhe praktikave më të mira dhe standardeve ndërkombëtare.

Gjithsesi, volumi i punëve të AAPSK-së varet nga numri i vendimeve nga gjykatat dhe pse jo cilësia e atyre vendimeve për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

9. Monitorimi dhe raportimi

Plani Strategjik i AAPSK-së 2026-2028 si pjesë integrale e ka edhe Planin e Veprimit po ashtu për periudhën 2026-2028. Plani i Veprimit ngërthen në vetvete aktivitetet, afatet, përgjegjësit për zbatim të aktivitetit përkatës, buxheti që do ta mbështesë zbatimin aktivitetit përkatës (buxhet i Kosovës apo donatorëve), outputin (produktin) që do të rezultojë nga zbatimi i aktivitetit përkatës.

AAPSK do të themelojë një strukturë për koordinim, monitorim dhe raportim të zbatimit të planit strategjik. Për secilën Objektivë Strategjike, do të caktohet një përgjegjës, i cili/e cila do ta monitorojë në baza të rregullta zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Objektivës strategjike përkatëse, rreziqeve potenciale si dhe arritjen e treguesve përmes të cilëve do të konfirmohet përmbushja e objektivave specifike dhe strategjike.

Po ashtu, AAPSK do të caktojë përgjegjësit për mbledhjen e raportimeve për secilën Objektivë Strategjike dhe përgatitjen e një raporti të konsoliduar, i cili do t'i përcillet AAPSK-së për vendimmarrje sa më të mirë-informuar. Struktura për koordinim, monitorim dhe raportim përmes një vendimi të AAPSK-së do t'i ketë të qarta rolet dhe përgjegjësitë për të siguruar zbatim adekuat të planit strategjik.

AAPSK do ta monitorojë planin strategjik në baza të rregullta, nëse do të ketë ndonjë vështirësi do t'i adresojë ato, ndërkohë që raportimet do t'i bëjë në baza vjetore si dhe një raport përfundimtar që reflekton vlerësimin e zbatimit të planit strategjik, vlerësim ky i cili do të bëhet në fund të vitit 2028, mbi bazën e të cilit pastaj AAPSK do të mund t'i projektojë orientimet e ardhshme në një plan të ri strategjik.

Varësisht prej zhvillimeve, plani strategjik duhet të rishikohet duke iu përshtatur zhvillimeve. Në qoftë se zbatimi i planit strategjik shkon sipas dinamikave të parapara, atëherë vazhdohet me zbatimin e tij, ndërsa nëse ndodhin ndryshime të mëdha p.sh. nuk themelohet fondi i konfiskimit, atëherë AAPSK duhet ta rishikojë planin strategjik dhe konform rishikimit ta përshtasë edhe Planin e Veprimit.

Krejtësisht në fund të planit strategjik, AAPSK duhet të bëjë një vlerësim përfundimtar, i cili do të përcaktonte shkallën e zbatimit të planit strategjik si dhe do të jepte orientimet e nevojshme për planifikimet e ardhshme.

10. Shtojcat

10.1.Dokumente të konsultuara

- 3.4. Plani Institucional i Ministrisë së Drejtësisë
- 3.5. Strategjia për Sundim të Ligjit 2021-2026.
- 3.6. Plani Kombëtar për Zhvillim 2026 – 2028.
- 3.7. Raportet Vjetore të AAPSK-së për vitin 2024 dhe 2025;
- 3.8. Raporti i BE-së për Kosovën i vitit 2025;
- 3.9. Raporti i Projektit PECK III;
- 3.10. Transparency International, Indeksi i Përceptimit të Korrupsionit (CPI2022)
- 3.11. Direktiva (BE) 2024/1260 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 24 prill 2024, për Rikthimin dhe Konfiskimin e Pasurisë

a. Plani i Veprimit 2026 – 2028						
1. Objektiva Strategjike: Forcimi i kapaciteteve të AAPSK-së në administrimin e PSK						
1.1. Objektiva Specifike: Përmirësimi i kornizës ligjore						
Aktivitetet	Emërimi i aktiviteteve	Afati	Zbatuesi	Buxheti		Outputi
				AAPSK	Donacione	
1.1.1.	Përpjekja për bashkëpunimin me institucionet ligji zbatuese për të qartësuar konsultimin me AAPSK-në dhe kërkesat për informacion	K2 2026		AAPSK		Ligji i ndryshuar
1.1.2.	Propozimi për ndryshim të legjislativit për të autorizuar AAPSK-në që të kërkojë drejtpërdrejt miratimin për shije para vendimit gjyqësor për fundimtar, në fazën e sekuestërimit, me qëllim ruajtjen e vlerës së aseteve	K2 2026		AAPSK		Ligji i ndryshuar
1.1.3.	Hartimi i dokumentit dhe modelit të qeverisjes për fondin e konfiskimit, dhe dorëzimi në institucionin kompetent	Vazhdimësi		AAPSK		Udhëzuesit e hartuar
1.2. Objektiva Specifike: Fuqizimi i kapaciteteve të specializuara dhe ekspertizës teknike						
1.2.1.	Plotësimi i pozitave të lira;	Vazhdimësi		AAPSK		Stafi i rekrutuar
1.2.2.	Trajnimi i stafit të AAPSK-së në fushën e shërbimit civil;	Vazhdimësi		AAPSK		Stafi i trajnuar
1.2.3.	Trajnime të avansura në fushën e administrimit të PSK-së;	Vazhdimësi			Donacione	Stafi i trajnuar
1.3. Objektiva Specifike: Dixhitalizimi i AAPSK-së						
1.3.1.	Krijimi i bazës së të dhënave për AAPSK-së dhe ndërlidhja me bazën e të dhënave (SMIL) të KGJK-së, KPK-së dhe Policisë;	K4 2027			Donacione	Bazat e të dhënave të ndërlidhura
1.3.2.	Finalizimi dhe funksionalizimi i platformës online për ankande për AAPSK;	K4 2026		AAPSK	Donacion	Platforma online funksionale
1.3.3.	Avancimi i bazës të të dhënave për pasurinë që administrohen në depo;	K4 2026			Donacione	Baza e të dhënave funksionale

Plani i Veprimit 2026 - 2028

2. Objektiva Strategjike: Avancimi i procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar

2.1. Objektiva Specificke: Modernizimi i vazhdueshëm i punës në AAPSK

Aktivitetet	Emërtimi i aktiviteteve	Afati	Zbatuesi	Buxheli		Outputi
				AAPSK	Donacione	
2.1.1.	Avancimi i procesit të pranimit;	Vazhdimësi		9,000.00 C		Avansimet e bëra
2.1.2.	Avancimi i procesit të vlerësimit të pasurive;	Vazhdimësi		9,000.00 €		Avansimet e bëra
2.1.3.	Avancimi i procesit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së vlerës;	Vazhdimësi		9,000.00 €		Avansimet e bëra
2.1.4.	Procesi i sigurimit të pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara nëpër kompani të sigurimeve;	Vazhdimësi		194,040.00 C		Avansimet e bëra
2.1.5.	Procesi i dhënies me qira të pasurive të paluajtshme;	Vazhdimësi		1,200.00€		Avansimet e bëra
2.1.6.	Avancimi i procesit të shitjes;	Vazhdimësi		7,500.00 C		Avansimet e bëra
2.1.7.	Procesi i kthimit të pasurisë së sekuestruar;	Vazhdimësi		AAPSK		Avansimet e bëra
2.1.8.	Procesi i dhënies në shfrytëzim i pasurisë së konfiskuar;	Vazhdimësi		AAPSK		Avansimet e bëra
2.1.9.	Avancimi i procesit të asgjësimit;	Vazhdimësi		5,000.00 C		Avansimet e bëra

2.2. Mundësimi i shitjes së PSK-së në fazën e hershme dhe forcimi i rolit të Agjencisë

2.2.1.	Parashtrimi i kërkesave prokurorisë për shitjen e PSK-së në fazën e sekuestrimit;	Vazhdimësi		AAPSK		Nr i kërkesave të parashtruara
2.2.1.	Ekzekutimi i vendimeve për shitje në fazën e sekuestrimit;	Vazhdimësi		AAPSK		Nr i ankandeve të realizuara
2.2.3.	Ruajtja e kundërvlerë së pasurive të shitura në fazën e sekuestrimit.	Vazhdimësi		AAPSK		Depozitat në BQK

2.3. Objektiva Specificke: Përmirësimi i infrastrukturës fizike

2.3.1.	Sigurimi i hapësirës për depon qendrore të AAPSK-së;	K4 2027				Hapësira e mjaftueshme për depo
2.3.2.	Rregullimi i infrastrukturës në depon qendrore të AAPSK-së;	K4 2027		500,000.00 €		Infrastrukturë e rregulluar
2.3.3.	Dislokimi i pasurive nga depoja qendrore ekzistuese e AAPSK-së;	K1 2028		100,000.00 €		Pasuritë e dislokuara
2.3.4.	Kërkesë për hapësirë të mjaftueshme për stafin e Agjencisë.	K2 2026				Hapësirë e mjaftueshme

Plani i Veprimit 2026 - 2028

3. Objektiva Strategjike: Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërkombëtar

3.1. Objektiva Specifike: Sensibilizimi mbi mbi rolin dhe mandatin e AAPSK-së

Aktivitetet	Afati	Zbatuesi	Buxheti		Output
			AAPSK	Donacione	
Emërtimi i aktiviteve					
3.1.1. Organizimi i takimeve të rregullta me institucionet e zbatimit të ligjit;	Vazhdimësi		AAPSK	Donacione	Takimet e organizuara
3.1.2. Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rolin dhe përgjegjësitë e AAPSK-së;	Vazhdimësi		5,500.00 €	Donacione	Fushatat e organizuara
3.1.3. Organizimi dhe pjesëmarrja në punëtori të përbashkëta me të gjithë akterët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë në lidhje me administrimin, sekuestrimin, konfiskimin e pasurive të paligjshme;	Vazhdimësi		20,000.00 €	Donacione	Punëtoritë e organizuara
3.1.4. Lidhja i MoU-ve me institucionet relevante;	Vazhdimësi		AAPSK		Memorandumet e nënshkruara

3.2. Rritja e ndërgjegjësimit për menaxhimin e pasurive dhe promovimi i AAPSK-së për të forcuar transparencën institucionale dhe besimin publik;

3.2.1. Krijimi i një videoje promovuese për punën e AAPSK-së	K4 2026		AAPSK		Videoja promovuese
3.2.2. Pjesëmarrja në aktivite ndërkombëtare;	Vazhdimësi		10,000.00 C		Numri i takimeve

3.3. Objektiva Specifike: Vazhdimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe përshtatja e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rajonale

3.3.1. Bashkëpunimi me institucionet qeveritare në fushën e ripërdorimit të pasurive të konfiskuara;	Vazhdimësi		AAPSK		Numri i takimeve
3.3.2. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare që janë aktive në luftimin e krimit;	Vazhdimësi		AAPSK		Aktivitetet e përbashkëta

3.4 Objektiva Specifike: Përmirësimi dhe promovimi i ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.

3.4.1. Funkcionalizimi i fondit të konfiskimit;	K4 2027		AAPSK		Fondi i funksionalizuar
3.4.2. Numri dhe vlera e pasurive të dhëna për ripërdorim social	Vazhdimësi		AAPSK		Numri i vendimeve

3.3.3.	Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare që kanë për prioritet ripërdorimin social të pasurisë së konfiskuar që buron nga krimi.	Vazhdimësi	AAPSK	Aktivitetet e përbashkëta
<i>Shpjegim: "K" do të thotë kuartali (çerëku i vitit)</i>				

b. Matrica e Kornizës Logjike

	Logjika e intervenimit	Treguesit	Burimet e Verifikimit	Rreziqet
Vizioni	-Agjenci qendrore moderne sa më profesionale në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar.	-Vlerësimet ndërkombëtare për procesin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme;	-Raport e BI-së dhe Këshillit të Evropës për Kosovën;	-Mungesa e vullnetit politik për ta parandaluar dhe luftuar korruptonin dhe krimin e organizuar, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme;
Misioni 4.	-Agjencia administron pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar në mënyrë sa më efektive dhe sa më efektive sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare;			
1.Objektiva Strategjike:	-1. Fuqizimi i AAPSK-së në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;	-Legjislacioni i hartuar;	-Gazeta Zyrtare;	-Vonesat në hartimin e legjislacionit;
Objektivat Specifike:	-1.1. Avancimi i kornizës ligjore;	-Raporti vjetor për majen e performancës së AAPSK-së;	-Webfaqja e AAPSK-së;	-Varësia nga nxjerrja e rregullores së brendshme për organizimin e MD-së që përfshin edhe agjencitë e varësise;
	-1.2. Ngritja e kapaciteteve të AAPSK-së;	-Funksionalizimi i procesit të dixhitalizimit;	-Raporti i BI-së dhe Këshillit të Evropës për Kosovën, etj.	-Mosndërfidhja e AAPSK-së me SMII;
	-1.3. Dixhitalizimi i AAPSK-së.			
2.Objektiva Strategjike:	-2. Avancimi i procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;	-Vlera e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;	-Webfaqja e AAPSK-së, KGJK-së, KPK-së, Policisë;	-Neglizhimi i rolit të AAPSK-së nga institucionet relevante;
Objektivat Specifike:	-2.1. Modernizimi dhe standardizimi i vazhdueshëm i punës së AAPSK-së;	-Numri i ankandeve të zhvilluara;	-Raporti vjetor i punës së qeverisë, KGJK-së, KPK-së, Policisë, etj.	-Interesimi u ulët i institucioneve në shfrytëzimin e pasurisë së paligjshme që është e konfiskuar.
	-2.2. Përmirësimi i infrastrukturës fizike;	-AAPSK që pranohen nga institucionet relevante;	-Raporti i BI-së dhe Këshillit të Evropës për Kosovën, etj.	
		-Hapësirat e depozitës për mirëmbajtjen;		
2.Objektiva Strategjike:	-3. Përforcimi i bashkëpunimit ndër-institucional;	-Numri i takimeve me institucione të zbatimit të ligjit;	-Webfaqja e AAPSK-së, KGJK-së, KPK-së, Policisë;	
	-3.1. Sensibilizimi i institucioneve mbi rolin e AAPSK-së;	-Nr. i Moti-ve të nënshkruara;	-Raporti vjetor i punës së qeverisë, KGJK-së, KPK-së, Policisë, etj.	
		-Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare;		

Objektivat Specifike:	3.2. <i>Rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombetare;</i> 3.3. <i>Ripërdorimi social i pasurisë së konfiskuar;</i>	-Numri dhe vlera e pasurisë së dhënë për ripërdorim social;	-Raporti i BE-së dhe Këshillit të Evropës për Kosovën, etj.	
Aktivitetet	(shih Planin e Veprimit)	(shih outputet në Plan të Veprimit)	-Raportimet e rregullta mbi zbatimin e Planit Strategjik;	